



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, nenit 20 paragrafi 3 pika 3.3 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 9,17,20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.01.2018, pas shqyrtimit të propozimit të vendimit të Kryetarit miratoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË LIPJAN

Neni 1

Me këtë vendim ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh prona komunale P-71409044-01166-0 në vendin e quajtur "Pashnike" me kulturë kullosë e klasit 1 me sipërfaqe prej 3465m², Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, për ndërtimin e xhamisë për nevojat e banorëve të Lipjanit.

Neni 2

Dhënia në shfrytëzim e parcelës siq përcaktohet në nenin 1 bëhet duke u bazuar në Planin Zhvillimor Urban, në bazë të cilit në parcelën e cekur më lartë është destinuar ndërtimi i objektit fetar-xhami në zonën ZUP 1 Lipjan.

Neni 3

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit të parcelës P-71409044-01166-0 me sipërfaqe prej 3465 m² shfrytëzues Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan siq përcaktohet në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 463-6514
Lipjan, më 01. 02. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



KRYESUESI I KUVENDIT
Daut Azemi